

ksionit ESSL në Vienë "Blood and Honwy, the future's in the balkans" me kuratorin Harald Szeemann.

Si arritët t'i vendosnit kontaktet me galeritë apo muzetë ku ju po prezantoni ekspositat apo veprat tuaja letrare?

Akademja, njohjet e bashkëpunimet e reja të njëpasnjëshme me artistët e kuratorët ishin baza e kontakteve, të cilat edhe pas studimeve vijuan.

Cila ka qenë pjesëmarrja juaj më e fundit në një veprimitari të rëndësishme? A mund të tregoni rrithët e prërturës me të cilën keni marrë pjesë? Rrith temës, subjektit apo për cilësitet e elementeve të formës?

Në këtë rast nuk mund të mos fash për projektin tim më të fundit të realizuar posaçërisht për eventin, që është ende në eksposizim deri në 22 nëntor të 2009, video audio instalacioni "SENSATION SEEKERS". Nëpërmjet ArtKontakt-it dhe Andi Tepelenës u bë e mundur pjesëmarrja ime me "Sensation Seekers" pikërisht në edicionin më të fundit të 53-të të Biennale-s së Venecias, një nga eventet më prestigjioze ndërkombëtare dhe në seksionin e saj kolateral "Krossing". SENSACTION SEEKERS, që në shqip do të mund të përkthehet "KËRKUESIT E EMOCIONEVE EKSTREME" (njerëzit në kërkim të adrenalinës) ka lindur si një multivëzhgim i personave që praktikojnë sporte ekstreme dhe si analizë e projektimit psikologjik të dëshirës dhe nevojës së çdokujt për të përkaluar formë të ndryshme kufiri, si moralë apo fizikë. Video instalacioni zhvillohet në tre projeksione. Video e projektuar në qendër, rrënjosore për të gjithë idenë e projektit, është një ngjarje e vërtetë, e cila ka ndodhur në janar të 2009 mbi majat e malit më të lartë të Argentinës, Akonaguas (6000 m). Ngjarja tragjike nuk do të ishte ditur po mos të ishte bërë publikimi nëpërmjet internetit nga një anonim, që e kishte regjistruar nëpërmjet një celulari, pikërisht nga një alpinist i grupit, protagonist i kësaj historie. Video më pas u regjistrua nga unë për herë të dytë, nëpërmjet një pëlhure, duke ridimensionuar personazhet në figura hijesh, duke mekanizuar lëvizjet e tyre, e duke shfaqur kështu edhe një herë tjetër momentet kyçe të vdekjes tragjike të guidës Federico Campanini, i braktisur nga grupei i aplinistev pikërisht 400 m nga maja e malit. Dëshira për të arritur një objektiv, format e saj të ndryshme, dhe nevoja për të kërkuar emocione ekstreme janë të pikat themelorë, që lidhin në një zinxhir qarkullor "Sensation Seekers".


Dy videot e tjera që komplettojnë instalacionin janë një analizë e dy elementeve që bëjnë pjesë në natyrën njerëzore dhe janë gjithmonë prezent në fenomenin e sensation seeking. E para projekton një fëmijë që realizon akrobaci në lisharëse, dukë vënë në dukje formën ekspressive të kërkimit të emocioneve ekstreme në fazën infantile, parë nëpërmjet lojës (në këtë rast lisharsja dhe rezultati i saj me efektin naiv dhe ekstrem, të marramendjes). Rethi mbyll me një vëzhgim të personave që praktikojnë rite dhe eksperiencia fetare (në këtë rast, vallja e dervishëve). Dervishët rrötullues, mjeshëtër të autokontrollit, besojnë që nëpërmjët marramendjes është e mundur të arrijnë një giendje ekstaze që i afrojn me Zotin. Lëvizjet e tyre të përsëritura dhe rrötulluese bashkë me lojën marramendëse të vajzës së vogël krijojnë një kuadër të komplektuar të faktorëve basilarë që kompozojnë fenomenin "sensation seeking". Njeriu është i predispozuar të shkojë në kërkim të emocioneve të tillë, nganjëherë edhe përtej kufirit, shpesh duke vënë në rrezik edhe ekzistencën e vet.

Çfarë ju nxit që të mban gjallë vrullin e krijuarit në gjininë dhe formën që keni zgjedhur?

Pasi. Një galerist milanëz pasi kishte parë video instalacionin tim më të fundit në Bienalen e Venecias "Sensation Seekers" më tha "...nuk je edhe ti një "sensation seeker" ("një kërkuese e emocioneve")?" Në doza të ndryshme jemi pak të gjithë...

Çfarë mendoni rrith artit bashkëkohor, ç'e bën atë të cilësohet i tillë dhe në cilin segment të tij bën pjesë krijuarit juaj?

Është bashkëkohor siç fjala vëtë e thotë, pasi jeton në të njëjtin hap me ne, me kohën tonë. E pamundur të marrë vlerën e saj të plotë që meriton. Vetëm në distancë kohe mund të analizohet, kur idetë të filtrohen. Përsa më përket mua, jam thjesht një kërkimtarë e pa-



sionit tim. Nuk bëj tjetër, vetëm t'a ndjek hijen e saj që më hap rrugën përpëra para t'a realizoj. Ndihem me fat kur shkoj që pasioni nga endrr të vizatohet e të marrë formë reale.

Subjektet apo temat tuaja janë burim i injohes së asaj që na rrëthon, i lidhjes me to, i qëndrueshme suaj brenda tyre apo burim improvisimi i çastit prej ndikimit të asaj që na rrëthon në një moment të caktuar e të menjëhershëm?

Mendoj më shumë ajo e para, nganjëherë e ndërthurur me të dytën. Shpesh i referohet edhe memories kolektive. Për këtë të fundit njohja ime rrith elementeve që më interesojnë studiohet në detaje për të filtruar sa më shumë informacion e për të arritur në thelb të idësime përfundimtare.

Sa shqiptare ndjehesh në eksposizimet e tua në botën e artit dhe sa e ndjejnë të tjerët këtë?

Në realizimin e projekteve të mia nuk marr parasysh prezentimin tim kombëtar përballë një publiku. Në disa nga veprat e mia kam folur për tematika që nuk kanë të bëjnë në mënyrë direkte me prejardhjen time, por publiku si shqiptar dhei i huaj është i vëmendshëm dhe shpesh kurioz për të gjetur elemente që kanë origjinë në rrënjet e prejardhjes sime. Ashtu si në një projekt të kaluar "Not choose not to be" (Të mos zgjedhesh, të mos ekzistosh), në 2004, ku në të kundërt, video mbarte në vvetet shumë elemente simbolike të lidhura me originën time dhe fëmijërinë, në këtë rast publiku reagoi në mënyrë shumë personale. Persona të ndryshëm personalizonin historinë, duke i dhënë kështu një vlerë pa hapësirë e kohës.

Ç'mendoni rrith mbiemrit shqiptar, italian apo turk në kuptimin e artistit si bërés i artit?

Sot gjithmonë e më shumë janë duke kërkuar të humbin kuptimin e tyre. Fatmirësisht jemi duke iu afruar një tjetër epoke historike ku kufinjtë që gjithmonë kanë krijuar ndarje e dhimbje po shkojnë drejt rrugës së humbjes së vlerave të tyre. Kështu artisti e identifikon vetveten në bazë të eksperiencës personale në vendin dhe kulturën që jeton nga një cast në një tjetër. Për këtë unë shpesh nënvízoj që memoria ka një rëndësi të veçantë për individin por dëshirat që përgjigjet.

Si mendoni a ka artistë të artit bashkëkohor dhë artistë bashkëkohës, të cilët zënë një vend të caktuar në mjetet e artit të sotëm? Ku e shihni veten dhe si e shihni atë?

Janë të panumërt artistët bashkëkohor që kanë një prezantim me impakt të fortë, kurasoj, dhe inteligjent në nivelin ndërkombëtar. Mund të përmirësoj ndër to: Olafur Eliasson, Monica Bonvicini, Pierre Huyghe, Tania Bruguera, Ghada Amer, Won Ju Lim, Bill Viola, Jeff Wall, Gregor Schneider, Abbas Kiarostami, e akoma ndër artistët shqiptarë si Adrian Paci e Anri Sala. Vetveten e shoh tek po ndjek pasionin tim me këmbëngulje, tashmë prej vitesh. Sa për të tjerat është publiku që përgjigjet.

Ju keni realizuar disa veprimitari në Tiranë? Ato kanë qenë shumë më të gjera se një eksposizitë e artit pamor apo kanë mbeetur aty tek kufijtë e tij? Mund të tregoni se të kujt tipi janë dhe si i ka pritur publiku?

...mbi të gjitha "Onufri" e "Colors of Albania" në Museun Kombëtar të Tiranës. Për Shqipërinë besoj kanë një vlerë superiore. Përsa i përket pjesëmarrjes sime personale, kufinjtë janë akoma të pranishëm në Shqipëri. Duke punuar shumë që zëri i ngjarjeve të ndryshme brenda territorit të prekë opinionin ndërkombëtar e të joshë interesat e një shypit të huaj. Por kjo nuk arrin vetëm nëpërmjet punës së madhë e të palodhshme të artistëve që tashmë kanë arritur nivelet më të larta profesionale. Një mbështetje e fortë e artistëve që punojnë Jashtë atdheut, nga ana e institucioneve publik o privat shqiptarë, si psh. në rastin e fundit të ArtKontakt-it, është e rëndësishme e shpesh rrënjosore për të ngritur zërin e artit bashkëkohor shqiptar në nivel ndërkombëtar. Artisti shqiptar që jeton Jashtë kufijve të Shqipërisë, duke punuar në mënyrë individuale mund të prezantohet me dinjitetë në nivelin ndërkombëtar duke hasur vështirësi të mëdha e të njëpasnjëshme, e mbi të gjitha pa mbështetje kombëtare. Në Bienalen e Venecias (gjeografikisht shumë pranë kufijve kombëtarë) pavioni zyrtar shqiptar ende është në dhomën e pritjes. Kjo duket se i lë një portë të hapur diskutimit.